



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:155629  
Datë: 17.11.2022  
Numri i dokumentit: 03657823

C.nr.339/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtarin Naim Rekalju, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “I.” sh.a, me seli në F. K. kundër të paditurit D. P. me banim tek Stacioni Hekurudhorë në P. V. lidhur me lirimin e pronës dhe pagesës së borxhit, jashtë seancës me datë 17.11.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. KONSIDEROHET se është tërhequr padia me numër C.nr.339/2022, e paditëses Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos”, sh.a me seli në F. K. e datës 01.08.2022, kundër të paditurit D. P. nga fshati P. komuna V. lidhur me çështjen juridike të lirimit të paluajtshmërisë dhe pagesës së borxhit.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësja Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “I.” sh.a, me seli në Fushë Kosovë, ka ushtruar padi kundër të paditurit D. P. me banim tek Stacioni Hekurudhorë në P.-V. për shkak të lirimit të pronës dhe pagesës së borxhit.

Gjykata, me qëllim që çështja të përgatitet sa më mirë për tu zgjidhur shpejt e drejt, ka nxjerrë aktvendim me të cilin ka obliguar të paditurin që pranë kësaj gjykate të paraqes përgjigjen në padinë e paditëses Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “I.” sh.a, për të paditurin D. P. nga

flete kthesa e datës 02.09.2022 është konstatuar se dorëzimi është provuar, mirëpo pala është shpërngulur.

Gjykata me qëllim të komunikimit me të paditurin, me aktvendimin e datës 12.09.2022, ka obliguar paditësin që të bëj plotësimin e padisë në drejtim të sigurimit të adresës së saktë për të paditurin D. P. në të kundërtën të bëj propozim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin, nën kërcënim të lëshimit.

Paditësja me parashtrësën e datës 26.09.2022, ka kërkuar nga gjykata një afat shtesë prej 15 ditësh në mënyrë që të siguroj adresën e saktë të të paditurit D. P. e të cilën kërkesë gjykata e ka aprovuar dhe me aktvendimin e datës 07.10.2022, të cilin paditësja e ka pranuar me datë 11.10.2022, i'a ka vazhduar afatin për plotësimin e padisë edhe për 15 ditë të tjera, njëherësh, gjykata e ka njoftuar paditësen edhe për pasojat e mos plotësimit të padisë, gjegjësisht e ka njoftuar se në qoftë se brenda afatit prej 3 ditësh nuk i dorëzon gjykatës plotësimin e padisë, gjykata do ta konsideroj të tërhequr padinë e paditësit, e nëse e dorëzon padinë pa e plotësuar, gjykata do të hedh poshtë padinë e tij, në kuptim të dispozitës së nenit 102.3 dhe 102.4 të LPK-së.

Meqenëse paditësja nuk e ka plotësuar padinë brenda afatit të përcaktuar nga gjykata, gjykata bazuar në pikën I dhe II të dispozitivit të aktvendimit të datës 07.10.2022, dhe në përputhje me bazën ligjore që buron nga Ligji për Procedurën Kontestimore, përkatësisht nenit 102 par. 3 të LPK-së, vendosi që padinë e paditëses ta konsideroj të tërhequr.

## GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.339/2022, datë 17.11.2022

Gj y q t a r i  
Naim Rekalii

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.